

NJOFTIM

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve për rikthim në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura, janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë qenë ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura si oficer, nënoficer ose ushtar/detar aktiv;
- Të mos jetë i dënuar;
- Të mos jetë në ndjekje penale dhe në proces gjykim;
- Të mos jetë larguar nga administrata publike për shkelje disiplinore (në rastet e punësimit);
- Të jetë i aftë nga ana shëndësore;
- Të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse;
- Të kenë moshë të tillë që mundëson lidhjen e të paktën e një kontrate shërbimi ushtarak me afat 3 vjeçar;

2. Procedura e aplikimit për rikthim në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura

Kandidati/aplikanti (ushtaraku në rezerve) për rikthim në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura të RSH si oficer, nënoficer dhe ushtarë/detarë aktiv, aplikon nëpërmjet platformës “e-albania”, dhe/ose në hard-copy pranë seksioneve të rekrutimit në qarqe dhe në Qendrën e Personel Rekrutimit duke plotësuar formularin e aplikimit për rikthimin e ushtarakëve në rezerve në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura dhe dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të shpallura brenda afatit të përcaktuar në këtë njoftim.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e kandidatëve për rikthim në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura.

Kandidati/aplikanti (ushtaraku në rezerve) për rikthim në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura duhet të paraqesë dokumentacionin shoqërues, origjinal apo të njehsuar me të si më poshtë:

1. Formulari i vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015;
2. Jetëshkrimi;
3. Vërtetimi nga prokuroria që kandidati nuk është në procedim penal;
4. Vërtetimi nga gjykata e rrethit gjyqësor që kandidati nuk është në proces gjyqësor penal;
5. Vërtetimi që kandidati të mos jetë larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike;
6. Vërtetimi mjekësor (dokumenti i aftësisë për punë i qendrës shëndetësore të lëshuar nga mjeku i familjes);

7. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit përkatës së bashku me listën e notave, për kohën që ka qenë jashtë Forcave të Armatosura, nëse ka;
8. Fotokopje e noterizuar e kualifikimeve të nevojshme për specialitetin që kërkohet rikthimi në shërbimin aktiv, nëse ka;
9. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore/dëshmi penaliteti;
10. Formulari i vetëdeklarimit gjyqësor dhe i vetëdeklarimit shëndetësor;
11. Formularin e kushtit të sigurisë;
12. Formularin e aplikimit për rikthim oficer, nënoficer, ushtar/detar.
13. Kërkesë me shkrim;
14. Fotokopjen e kartës së identitetit.

Për informacion më të detajuar mbi procedurat e rikthimit të ushtarakëve në rezervë në shërbimin aktiv, vizitoni faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Mbrojtjes:

[https://www.mod.gov.al/rezervistet-Rikthim në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë](https://www.mod.gov.al/rezervistet-Rikthim%20n%C3%AB%20Forcat%20e%20Armatosura%20t%C3%AB%20Republik%C3%AB%20s%C3%AB%20Shqip%C3%AB%20ris%C3%AB%20), ku do të gjeni bazën ligjore, procedurat dhe formularët përkatës.

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT